

Shënim i redaksisë - kërkim falje për UBT dhe lexuesit

GJnK nëpërmjet këtij shënimi i kërkon ndjesë Kolegjit UBT dhe lexuesve për lëshime të cilat kanë ndodhur pa qëllim në publikimin e parë artikullit me titull “Lista e programeve që nuk u akredituan në UBT”.

Artikulli në fjalë përmban të dhëna nga monitorimi direkt i Mbledhjeve të Këshillit të Cilësisë ku anëtarët kanë diskutuar për akreditimin e programeve të të gjitha universiteteve.

Gazeta Jeta në Kosovë pas publikimit të lajmit fillestar nga ky monitorim ka pranuar një reagim nga kolegji UBT, gazeta JnK ka kërkuar sqarime për gabimet e mundshme në tekst por nuk ka marrë sqarime.

Gazeta menjëherë ka ndërmarrë veprime për ti ri-vërtetuar të dhënat.

Është vërejtur se ka lëshime teknike në informacione të cilat menjëherë janë përmirësuar.

Si rrjedhojë teksti burimor është edituar si në vijim:

1. Numri i programeve të akredituara dhe të pa akredituara në paragrafët 1, 3, 4, 11 dhe 17.
2. Në paragrafin 6 dhe 7 është shtuar programi 'Inxhinieri Ndërtimore (Ndërtimtari) dhe Infrastrukturë', ndërsa në paragrafin 9 janë hequr programet 'Juridik' në nivelin Bachelor në Prishtinë dhe 'Sistemet e Informacionit dhe Menaxhment' në nivelin Master i shkencës në Prishtinë.
3. Në paragrafin 12 dhe 13 janë përmirësuar emrat e programeve dhe janë precizuar nivelet e tyre.

Teksti i edituar me përmirësime është i qasshëm për lexuesit në linkun burimor: <https://kallxo.com/gjnk/lista-e-programeve-qe-nuk-u-akredituan-ne-ubt/>.